



**Instituti Kombëtar
i Shëndetësisë
Publike të Kosovës**



Revista “Shëndeti”

2025

Numër revial për nder të 100-vjetorit të themelimit të IKSHPK-së

Botuar: IKSHPK, 31/12/2025



FJALË HYRËSE PËR NUMRIN REVIAL TË REVISTËS “SHËNDETI”



Dr. Sc. Ardita Baraku

Drejtor Ekzekutiv - IKSHPK

Në cilësinë e Kryeredaktorit të revistës online, kam kënaqësinë të prezantoj numrin revial të revistës “SHËNDETI”, një botim me rëndësi të veçantë historike dhe institucionale.

Revista “SHËNDETI” është botuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) deri në vitin 1990, duke shërbyer si platformë për informim dhe edukim shëndetësor. Gjatë periudhës së botimit të saj, revista është shpërndarë në të gjitha viset e Kosovës, në institucione arsimore, shkolla dhe organizata punuese, me qëllim të ngritjes së nivelit të edukimit shëndetësor të popullatës dhe forcimit të praktikave të shëndetit publik.

Me suprimimin e autonomisë së Kosovës, botimi i revistës u ndërpre, duke ndërprerë një traditë të rëndësishme të komunikimit institucional në fushën e shëndetit publik.

Publikimi i këtij numri revial realizohet në kuadër të 100-vjetorit të themelimit të IKSHPK-së dhe përfaqëson një akt përkujtimor, si dhe një rikthim simbolik të një botimi që ka pasur ndikim të rëndësishëm në shëndet dhe shoqëri. Ky numër që përmbledh vetëm disa nga aktivitetet e realizuara nga IKSHPK dhe QRSHP-të, synon të ruajë kujtesën institucionale dhe të vlerësojë kontributin e profesionistëve që, përmes revistës “SHËNDETI”, kanë ndihmuar në avancimin e shëndetit publik në Kosovë.

Ky botim nuk synon vetëm reflektimin mbi të kaluarën, por gjithashtu shpreh vullnetin dhe shpresën institucionale që revista “SHËNDETI” të mund të vazhdojë botimin e saj në të ardhmen, duke u përshtatur me zhvillimet bashkëkohore dhe nevojat aktuale të shëndetit publik.

Me respekt,

Kryeredaktori

Revista “SHËNDETI”



PËRMBAJTJA

1. Dr. Sc Ardita Baraku: Aktivitetet e realizuara për shënimin e 100 vjetorit të IKSHPK.....	1
2. Prof. Dr Merita Berisha: Simpoziumi Ndërkombëtar “Concha Colomer”	2
3. Dr. Lendita Mehmeti & Dr. Lindita Maxhuni: Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike në shëndetin e popullatës së Kosovës.....	3
4. Dr. Lindita Maxhuni & Dr. Lendita Mehmeti: Konsumimi i kripës si sfidë e shëndetit publik.....	4
5. Prof. Asoc. Dr. Sanije Gashi: Raportimi i sëmundjeve kronike jongjitëse në regjistrin popullor të IKSHPK.....	5
6. Prof. Dr Tahire Maloku- Gjergji, Dr. Lindita Maxhuni, Dr. Lendita Mehmeti: Uji, Sanitacioni dhe higjiena në shkollat e Kosovës gjatë vitit 2022.....	6
7. MSc. Hana Arifi: Raporti për vizitat monitoruese të IKSHPK dhe QRSHP lidhur me funksionalizimin e SMSN.....	7
8. Dr. Miranda Lutfiu-Sahiti, Dr. Mirlinda Bytyqi: Trajnim ndërkombëtar për përgatitje dhe reagim ndaj rreziqeve Kimike, Biologjike, Radiologjike dhe Bërthamore (CBRN).....	8
9. Prof. Dr Merita Berisha: Shkolla verore ndërkombëtare për Promovim dhe Edukim Shëndetësor.....	9
10. Ass.Dr.sci Rrezarta Bajrami Halili: Edukimi i vazhdueshëm profesional në diagnostikimin e Tuberkulozit.....	10
11. Dr. Aferdita Kuqi-Hyseni: EVP: Edukimi i vazhdueshëm profesional për metodat identifikuese të Haemophilus influenzae.....	11
12. Dr. Teuta Fejza: Aktivitetet sportive për nder të 100 vjetorit të IKSHPK me moton “100 vjet për Shëndet”	12
13. Dr. Adnora Nurboja: Konferenca e IV-të Rajonale e Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor.....	13
14. Dr. Shpresa Kushja: Trajnimi: “Epidemic Intelligence në ECDC”	14
15. Dr. Hidajete Halimi: Prevalenca e konsumimit të substancave narkotike te maturantët e rajonit të Gjilanit.....	15
16. Dr. Donjeta Pllana: Reduktimi i kërcënimeve terroriste dhe forcimi i biosigurisë në Ballkanin Juglindor: një qasje e integruar në detektimin dhe diagnostikimin e patogjenëve emergjent.....	16
17. Dr. Mirlinda Bytyqi: Përvoja nga shkolla verore e Shëndetit Publik “Andrija Štampar”	17
18. Dr. Albiona Rashiti- Bytyçi: Përvoja nga shkolla verore “Barra e sëmundjeve infektive”	18
19. Dr. Lendita Mehmeti & Dr. Lindita Maxhuni: Vlerësimi i situatës epidemiologjike të refugjatëve nga Afganistani, 2021-2022.....	19
20. Dr. Besa Sutaj: Vlerësimi i kushteve higjieno-sanitare në shkolla dhe çerdhe të Rajonit të Prishtinës,.....	20
21. Dr. Miranda Lutfiu-Sahiti, Dr. Mirlinda Bytyqi, Dr. Edona Sadiki, Dr. Shpresa Kushaj: Trajnim profesional në fushën e mbikëqyrjes epidemiologjike.....	21
22. Dr.Valbona Maloku: Përvoja nga Konferenca Ndërkombëtare: “Ndërhyrja në fëmijërinë e hershme”	22



PËRMBAJTJA

23. Dr. Edona Sadiki: Përvoja në “ECDC fellowship Introductory Course 2025”	23
24. MSc. Leutrim Murati: Përvoja nga konferenca AllWeb.....	24
25. Dr. Albiona Rashiti-Bytyçi, Dr. Besfort Kryeziu, Dr. Donjet Bislimi: Trajnim profesional për përdorimin e gjuhës programuese R dhe RStudio.....	25
26. Dr. Pranvera Kaçaniku- Gunga: IKSHPK pranohet në Rrjetin Global për Alarm dhe Reagim ndaj Shpërthimeve (GOARN).....	26
27. Prof.Asoc.Dr Valbona Zhjeqi: Matja e kënaqshmërisë së pacientit në tre nivelet e kujdesit shëndetësor në Kosovë.....	27
28. Dr. Shqipe Krasniqi-Kola: Ushtrimi simulues “Operation Vector”	28
29. Dr. Besfort Kryeziu: Analiza gjeografike dhe hapësinore e sëmundjeve ngjitëse në rajonin e Prishtinës.....	29
30. Prof. Ass. Dr Xhevat Jakupi: Vizita binjakëzuese në Departamentin e Mikrobiologjisë të Laboratorëve Referentë Shëndetësore të Luksemburgut.....	30
31. Dr. Aferdita Kuqi-Hyseni, Dr. Afërdita Kurti-Meta: Trajnimi teorik dhe praktik për izolimin, identifikimin dhe rezistencën antimikrobike të baktereve anaerobe	31
32. Dr. Teuta Musliu: Helmimet me ushqim gjatë vitit 2024 në Kosovë.....	32
33. Prof.Asoc.Dr. Sanije Gashi: Vjetarët statistikor të departamentit të statistikave shëndetësore në IKSHPK.....	33
34. Prof.Asoc.Dr. Sanije Gashi: Përvoja nga punëtorja për raportimin e Sëmundjeve Kronike Jongjitëse.....	34
35. Dr. Sanije Xhemajli: Themelimi dhe funksionalizimi i QRSHP Prishtinë.....	35

REDAKSIA

Kryeredaktor: Dr. Sc Ardita Baraku

Redaktorë:

Prof. Dr Merita Berisha, Prof. Asoc. Dr Sanije Gashi, Dr. Albiona Rashiti-Bytyqi, Dr. Ergyl Binçe, Dr. Arsim Kurti

Anëtarë:

Dr. Sanije Xhemajli, Dr. Teuta Fejza, Dr. Adnora Nurboja, Dr. Safete Kamberi, Dr. Fadil Kryeziu, Dr. Sevdie Mehmeti, Dr. Ajhan Sefiu

Dizajn dhe faqosje:

MSc. Leutrim Murati



Dr. sci Ardit Baraku
Drejtor Ekzekutiv
IKSHPK

AKTIVITETET E REALIZUARA PËR SHËNIMIN E 100 VJETORIT TË IKSHPK

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) me datë 5 qershor festoi 100 vjetorin e themelimit, duke bërë reflektim mbi punën e bërë, sfidat e kaluara dhe të gjithë atyre që dhanë kontribut të çmuar në fushën e shëndetit publik, manifestim ky i cili u transmetua drejtëpërdrejtë nga RTK e cila poshtu përgatiti dokumentarin “Gjurmë-100 vjet për shëndet”.

Gjatë vitit 2025 nën moton “100 vjet për shëndet” janë realizuar një sërë aktivitete për të nderuar një shekull pune të palodhur dhe kontributin e jashtëzakonshëm të këtij instituti në mbrojtjen e shëndetit publik në vendin tonë.

Me këtë rast u organizua Konferenca e IV Rajonale të Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor me temën bosht: “Fuqizimi i komuniteteve të shëndetshme – arritjet dhe sfidat në promovimin e shëndetit”. Një vëmendje të veçantë patën Simpoziumi Ndërkombëtar “Concha Colomer” i formatit hibrid dhe Shkolla Verore Ndërkombëtare të organizuara për herë të parë në Kosovë në bashkëpunim në mes të IKSHPK dhe Konsorciumit Evropian të Trajnimeve në Shëndet Publik dhe Promovim Shëndetësor (European Training Consortium, Public Health and Health Promotion, ETC- PHHP) me temë “Komunikimi për Promovimin e Shëndetit”. Të gjitha këto organizime ishin me pjesëmarrës dhe ligjërues eminent ndërkombëtar dhe vendor.

Për nder të shënimit të 100-vjetorit të themelimit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), janë vendosur pllakat përkujtimore në objektet e QRSHP Pej edhe QRSHP Prizren. Poashtu Filatelia e Postës së Kosovës, ka vënë në qarkullim një emision të veçantë pullash postare me titull “100-vjetori i punës së IKShPK-së”.

Gjatë gjithë vitit 2025 janë zhvilluar aktivitete sportive dhe turnire futbollit, pingpongu dhe basketbolli me profesionistë, fëmijë dhe qytetarë. Poashtu janë mbajtur fushata senzibilizuese për tema të ndryshme të shëndetit dhe janë përgatitur dhe shpërndarë materiale edukativo-shëndetësore. Në dorëshkrim janë albumi jubilar i punëtorëve dhe Monografia e 100 vjetorit të IKSHPK.

IKSHPK vazhdon të mbetet shtyllë e fortë në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të individit dhe shoqërisë, mbikëqyrjen e faktorëve mjedisor që ndikojnë në shëndet, parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse, si dhe promovimin e shëndetit gjatë tërë jetës”, thuhet në njoftim.





Prof.Dr. Merita Berisha
Departamenti i Mjekësisë Sociale
IKSHPK

SIMPOZIUMI NDËRKOMBËTAR “CONCHA COLOMER”

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Departamenti i Mjekësisë Sociale kanë organizuar Simpoziumin e 13 Ndërkombëtar Concha Colomer, në bashkëpunim me European Training Consortium, IUHPE, Fakultetin e Mjekësisë/UP, me datë 24 janar 2025.

Simpoziumi ishte i organizuar në formatin hibrid dhe i pari i llojit të tillë i organizuar në Kosovë. Tema bosht ishte: ”Komunikimi për promovimin shëndetësor”.

Pjesëmarrës me prezencë fizike ishin rreth 70-80 profesionistë shëndetësor dhe studentë, kurse me prezencë online ishin rreth 40-50 participantë. Simpoziumi është mbajtur në Dekanatin e ri të Fakultetit të Mjekësisë, me përkrahje logjistike dhe teknike nga projekti AQH në Kosovë.

Fjalët hyrëse u mbajtën nga nikoqirët, Prof. Merita Berisha, për të vazhduar me ko-koordinatorët e ETC - European Training Consortium, përfaqësuesi i EUPHA, zëvendësministren e MSH, Sekretarin e Përgjithshëm të MSh, Drejtoreshën ekzekutive të IKShPK, Zëvendës Rektorin e UP, Dekanin e FM.

Temat e trajtuara ishin salutogjeneza dhe dialogu salutogjenik, world kafe, komunikimi salutogjenik në vendin e punës, shkolla, komunitete, universitete, qytete. Sesioni i pasdites ishte i organizuar në 4 workshope: SIM, Ecja me Mrs. X, Photo voice, Participatory Action Research, kurse online u realizuan 2 workshope: Sim dhe Virtual photo voice.



Dr. Lendita Mehmeti & Dr. Lindita Maxhuni
Departamenti i Ekologjisë Humane
IKSHPK

VLERËSIMI I NDIKIMIT TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË SHËNDETIN E POPULLATËS SË KOSOVËS

Ndryshimet klimatike ndikojnë në jetën dhe shëndetin e njerëzve në mënyra të ndryshme. Temperaturat e larta dhe valët e të nxehtit lidhen me morbiditetet dhe mortalitetet të lartë, veçanërisht tek grupet vulnerable të popullsisë. Sëmundjet infektive që transmetohen përmes ushqimit dhe ujit kanë një shkallë të lartë incidence dhe mund të përkeqësohen nga ekstremet klimatike, si valët e të nxehtit, përmytjet dhe thatësitat.

Ekstemet klimatike mund të rrisin ngarkesën në sistemin shëndetësor, duke shtuar numrin e vizitave në emergjencë, shtrimet në spital, lindjet e parakohshme, probleme në shëndetin mendor dhe efekte të tjera negative shëndetësore. Kjo kërkon shtim të fuqisë punëtore për të mbrojtur popullatën nga një gamë e gjerë rreziqesh klimatike.

Për vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike në shëndetin e popullatës është analizuar profili klimatik në vend dhe rajon në të kaluarën, të tanishmen dhe projeksionet e klimës në të ardhmen. Kosova ka klimë kryesisht kontinentale, me vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë, me temperatura që variojnë nga -27°C në dimër deri në 39°C në verë. Rritja e regjistruar e temperaturës në periudhën 2001-2020 ishte 1.0-1.3 $^{\circ}\text{C}$. Sasitë e reshjeve vjetore në vend janë duke u rritur dhe variojnë nga 600 mm në pjesën lindore të Kosovës në 1300 mm në malet perëndimore të vendit. Përmytjet më shpesh prekin rajonet përgjatë lumenjve Drini i Bardhë, Ibër - Lepenc, dhe mungesa e ujit të mjaftueshëm është më e zakonshme në zonat e ulëta në pjesët qendrore dhe lindore të vendit. Analizat e dy skenarëve klimatikë (RCP4.5 dhe RCP 8.5) për dy ekstreme klimatike (temperaturën dhe sasinë e reshjeve) konfirmuan parashikimet se deri në fund të këtij shekulli në Kosovë, do të ketë rritje të mëtejshme të temperaturës mesatare dhe rënie të sasië së reshjeve (sidomos në verë).



Profili shëndetësor, përcaktuesit demografikë dhe socio-ekonomikë të shëndetit, mortaliteti, morbiditeti, të dhëna për cilësinë e ujit, ushqimit, cilësinë e ajrit për periudhën 2017-2022.

Sëmundjet e qarkullimit të gjakut dhe tumoret janë ndër shkaqet më të shpeshta të vdekjes në Kosovë. Vdekshmëria më e lartë paraqitet në mesin e popullatës më të cenueshme mbi 65 vjeç (mbi 70% e vdekshmërisë totale). Gjatë periudhës së observimit sëmundjet infektive më të shpeshta ishin salmoneloza dhe diarea akute derisa sëmundjet vektoriale si Sëmundja Lyme, virusi i Nilit Perëndimor dhe malaria ndodhën vetëm herë pas here. Me ndihmën e pyetësorëve të OBSH së është bërë vlerësimi i përgatitjes së institucioneve shëndetësore për t'u përballur me rreziqet klimatike (valët e të nxehtit, përmytjet, thatësitat).

Niveli i rrezikut mund të konsiderohet si mesatar në pothuajse të gjitha institucionet e vlerësuara. Pika të dobëta në objektet e institucioneve shëndetësore janë infrastruktura dhe procesi teknologjik, të përcjellura me mangësi në përgatitjen e fuqisë punëtore të kujdesit shëndetësor për të reaguar në situatat ekstreme klimatike. Mungesa e një Plani Emergjence për të mbrojtur punëtorë shëndetësor nga rreziqet e shumta biologjike dhe kimike rrit rrezikun e përgjithshëm të efekteve negative të përmytjeve.

Të gjitha informacionet e marra ndihmuan në krijimin e një matriksi të riskut i cili paraqet informacione si:

- Situata ekstreme klimatike që po ndodh ose pritet të ndodhë në të ardhmen
- Rreziku i mundshëm shëndetësor
- Grupe të cenueshme të popullsisë
- Regjione të cenueshme
- Vlerësimi nga ekspertët (rreziku aktual), pasojat në sektorin e shëndetësisë
- Treguesit (indikatorët) që duhet të analizohen për monitorimin e rrezikut/pasojave

Dr. Lindita Maxhuni & Dr. Lendita Mehmeti
Departamenti i Ekologjisë Humane
IKSHPK

KONSUMIMI I KRIPËS SI SFIDË E SHËNDETIT PUBLIK

Nevoja fiziologjike ditore për NaCl është më pak se një gram në ditë, ndërsa sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) rekomandohet deri në 5 g në ditë. Trupi i njeriut mund të mbijetojë me doza shumë më të vogla kripe, rreth 0.2 g, falë aftësisë së tij për të ruajtur natriumin dhe për të reduktuar ndjeshëm humbjet përmes urinës dhe djersës.

Shumë studime kanë treguar se konsumi i kripës është një nga faktorët kryesorë në rritjen e presionit të gjakut (BP) dhe në incidencën e sëmundjeve kardiovaskulare. Marrja e shtuar e kripës rrit rrezikun për infarkt të miokardit, hipertrofi të ventrikulit të majtë dhe sëmundje të veshkave. Për më tepër, konsumi i lartë i kripës, së bashku me reduktimin e konsumit të lëngjeve, lidhet me obezitetet, gurë në veshka, osteoporozë dhe kancer të stomakut.

Në nivel global, vlerësohet se rreth 7.1 milionë vdekje (13% e totalit) i atribuohen presionit të lartë të gjakut, të përcaktuar si presion sistolik >115 mmHg. Studimet gjithashtu tregojnë se marrja e lartë e kripës shoqërohet me rritje të presionit arterial, rritje të shkallës së filtrimit glomerular (GFR), shfaqje të proteinurisë dhe përshpejtim të progresionit të insuficiencës renale.

Osteoporozja përbën një problem të rëndësishëm shëndetësor në nivel global, ku kequshqyerja, përfshirë marrjen e tepërt të kripës, është një faktor kryesor kontribues në shfaqjen dhe zhvillimin e saj, po ashtu mbipesha dhe obeziteti lidhen me konsum të shtuar të kripës.

Vlerat mesatare të natriumit të ekskretuar përmes urinës 24-orëshe tek qytetarët e Kosovës janë të larta, me një mesatare prej 9.52 g/ditë. Po ashtu, mesatarja ditore e konsumit të kripës në popullatë rezulton e lartë (23.8 g/ditë). Gjinia mashkullore konsumon një sasi dukshëm më të madhe kripe gjatë ditës (29.46 g/ditë) krahasuar me gjininë femërore (18.94 g/ditë).

Një reduktim edhe modest i marrjes së kripës konsiderohet si një hap i rëndësishëm për përmirësimin e shëndetit publik. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të zbatohet një strategji kombëtare për uljen e konsumit të kripës, duke përfshirë reduktimin e përmbajtjes së kripës në produktet ushqimore të prodhuara në vend dhe edukimin e vazhdueshëm të qytetarëve mbi rëndësinë e uljes së kripës në dietën e tyre.



RAPORTIMI I SËMUNDJEVE KRONIKE JONGJITËSE NË REGJISTRIN POPULATIV TË IKSHPK



Sëmundjet kronike jongjitëse janë problem madhor i shëndetit publik. Ato janë shkaku kryesor i vdekjeve në mbarë botën. Një e treta (28 milion) e vdekjeve që lidhen me këto sëmundje ndodhin në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Nga këto vdekje, 46.2% (17.5 milion) janë shkaktuar nga sëmundjet kardiovaskulare, 21.7% (8.2 milion) nga sëmundjet kancerogjene, 10.7% (4 milion) nga sëmundjet kronike të traktit respirator dhe 4% (1.5 milion) nga diabeti.

Këto sëmundje janë të lidhura me stilin e jetesës dhe faktorët e rrezikut si pirja e duhanit, dieta jo e shëndetshme dhe mos aktiviteti fizik dhe mund të parandalohen, ose së paku të shtyhen, përmes një jetese të shëndetshme.

Programi gjithëpërfshirës i kontrollit të sëmundjeve jongjitëse kërkon një sistem të mbikëqyrjes së tyre, determinanteve dhe rezultateve. Mbikëqyrja është mbledhje e vazhduar e të dhënave për vendim-marrjen në shëndetin publik duke siguruar informata mbi këto sëmundje dhe faktorët e rrezikut.

Raportimi i të dhënave shëndetësore rregullohet me Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125 ku neni 49 precizon se “Të gjitha institucionet shëndetësore si dhe personat përgjegjës juridik dhe fizik janë të detyruar të grumbullojnë të dhënat shëndetësore, t’i ruajnë dhe t’i raportojnë ato në SISH, në pajtim me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria” ndërsa Udhëzimi Administrativ (UA) 11/2013 i Ministrisë së Shëndetësisë “Sistemi i informatave shëndetësore dhe raportimi i të dhënave statistikore shëndetësore”, precizon se të gjitha institucionet shëndetësore e kanë për obligim raportimin e aktiviteteve të tyre profesionale, dhe duhet të zbatohet në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private. Në këtë udhëzim janë fletëparaqitjet obligative për raportimin e të dhënave shëndetësore.

Pas aprovimit të këtij udhëzimi nga MSH, IKSHPK ka filluar grumbullimin e fletëparaqitjeve të sëmundjeve masovike jongjitëse, me leter dhe excel formë. Ekziston strukturë menaxhuese qartë e definuar në IKSHPK përmes regjistrin populativ në Departamentin e Statistikave Shëndetësore në IKSHPK dhe njësitë të SISH në gjashtë QRSHP. Mungon infrastruktura softuerike adekuate.

Sipas të dhënave të regjistrin populativ për vitin 2024, tri sëmundjet kronike më të shpeshta janë Hipertension arterial primar me 49.2%, Diabeti mellitus Tip I dhe II me 33.1%, dhe Infarkti akut i miokardit me 5.4%. Sipas gjinisë, Hipertensionin arterial primar ka qenë me i lartë te femrat (F 65.6% vs. M 34.4%). Diabeti mellitus Tip I dhe II ka qenë me i lartë te femrat (F 59.4% vs. M 40.5%) kurse, Infarkti akut i miokardit më i lartë te meshkujt (M 71.8% vs. F 28.2%).

Prof. Dr Tahire Maloku- Gjergji, Dr. Lindita Maxhuni, Dr. Lendita Mehmeti
Departamenti i Ekologjisë Humane
IKSHPK

UJI, SANITACIONI DHE HIGJIENA NË SHKOLLAT E KOSOVËS GJATË VITIT 2022

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHPK), mbështetur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në vitin 2022 ka realizuar një hulumtim për vlerësimin e WASH/UHS në 100 shkolla të Kosovës të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme.

Për realizimin e objektivave të parashtruara, si instrument kërkimi janë përdorur pyetësorë të standardizuar të OBSH-së, të përshtatur në kontekstin e Kosovës dhe atë një pyetësor për staf/administrator në shkolla, një pyetësor për nxënës dhe një pyetësor për specialist të shëndetit publik (inspektues të shkollave).

Gjithsej në hulumtim morën pjesë 104 administratorë dhe 1938 nxënës të shkollave të përzgjedhura.

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se:

- pothuajse gjysma e ndërtesave të shkollave (41%) janë më të vjetra se 31 vjet;
- shumica (89%) e administratorëve të shkollave, pohojnë se shkollat kanë në dispozicion të përhershëm ujë për pije, kurse sipas perceptimit të nxënësve kjo përqindje është dukshëm më e ulët (50%);
- më shumë se gjysma e nxënësve (58%) deklarojnë se gjatë qëndrimit në shkollë nuk pijnë fare ujë;
- shumica e mostrave të ujit rezultuan pa kontaminim bakteriologjik dhe kimik, por klori residual ishte nën vlerat standarde apo edhe mungonte fare;
- më shumë se tri të katërtat e shkollave (84%) ishin të kyqura në rrjetin e kanalizimit qoftë lokal apo qendror dhe më shumë se dy të tretat e tyre (71%) kishin tualete të lidhura me rrjetin e ujësjellësve;
- shumica e shkollave (95%) kishin ujë dhe sapun, kurse më shumë se dy të tretat (69%) e shkollave nuk kishin në dispozicion letër higjienike;
- shumica e shkollave në Kosovë (87%) kishin mbulueshmëri me shërbim bazik për ujë për pije, 88% ofrojnë shërbimin bazik sanitar si dhe 93% e tyre kishin mbulueshmëri me shërbim bazik për higjienë - larje e duarve me ujë dhe sapun.

Bazuar në gjetjet e hulumtimit rekomandojmë të bëhet rinovimi i objekteve shkollore, mbështetja financiare me produkte hargjuese, mirëmbajtja e rregullt e nyjeve sanitare dhe sigurimi i furnizimit të rregullt me ujë për pije.



Dr. Miranda Lutfiu-Sahiti, Dr. Mirlinda Bytyqi
Departamenti i Epidemiologjisë
IKSHPK

TRAJNIM NDËRKOMBËTAR PËR PËRGATITJE DHE REAGIM NDAJ RREZIQEVE KIMIKE, BIOLOGJIKE, RADIOLOGJIKE DHE BËRTHAMORE (CBRN)

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve profesionale në shëndetin publik gjatë shkollimit specialistik, dy specializantët përfaqësues nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) morën pjesë në Modulin për Rreziqet Kimike, Biologjike, Radiologjike dhe Bërthamore (CBRN), të organizuar nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC), në kuadër të programit MediPIET. Moduli u mbajt nga data 7-11 prill 2025, në Budva, Mali i Zi, dhe kishte për qëllim fuqizimin e njohurive dhe aftësive praktike të profesionistëve të shëndetit publik për përgatitje, zbulim të hershëm dhe reagim efektiv ndaj ngjarjeve që kërcënojnë shëndetin e popullatës si pasojë e agjentëve CBRN.

Trajnimi përfshiu ligjërata të avancuara, ushtrime praktike dhe diskutime të bazuara në skenarë realë, të udhëhequra nga ekspertë ndërkombëtarë të ECDC-së, institucioneve akademike, shërbimeve të sigurisë dhe shëndetit publik nga vende të ndryshme evropiane. Temat kryesore përfshinë njohjen dhe efektet shëndetësore të agjentëve kimikë, biologjikë, radiologjikë dhe bërthamorë, mbikëqyrjen epidemiologjike për kërcënime jokonvencionale, inteligjencën epidemike, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, si dhe koordinimin ndërsektorial gjatë incidenteve CBRN.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua njohjes së hershme të ngjarjeve të qëllimshme ose aksidentale, menaxhimit të vendit të ngjarjes, trajtimit të personave të ekspozuar, parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve, përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale (PPE), si dhe komunikimit të riskut me publikun, profesionistët dhe vendimmarrësit. Po ashtu, u trajtuan parimet e sigurisë dhe shëndetit në punë për punonjësit shëndetësorë dhe roli i ushtrimeve të bazuara në skenarë për përmirësimin e gatishmërisë institucionale.

Metodologjia e modulit ishte interaktive dhe praktike, duke kombinuar sesione plenare, punë në grupe, ushtrime simulimi dhe vlerësime para dhe pas trajnimit. Pjesëmarrësit patën mundësinë të shkëmbejnë përvoja profesionale dhe të forcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e përgatitjes dhe reagimit ndaj emergjencave komplekse shëndetësore.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të IKSHPK-së në këtë modul përfaqëson një hap të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve kombëtare për përballimin e rreziqeve CBRN, duke kontribuar në forcimin e sigurisë shëndetësore, gatishmërisë emergjente dhe mbrojtjes së shëndetit publik në Kosovë, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane.





Prof.Dr. Merita Berisha
Departamenti i Mjekësisë Sociale
IKSHPK

SHKOLLA VERORE NDËRKOMBËTARE PËR PROMOVIM DHE EDUKIM SHËNDETËSOR

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Departamenti i Mjekësisë Sociale kanë organizuar Shkollën verore, në bashkëpunim me Konsorciumin Evropian të trajnimeve në shëndet publik dhe promovim shëndetësor (European Training Consortium, Public Health and Health Promotion, ETC- PHHP), Asociacionin Kosovar të Promovuesve dhe Edukatorëve Shëndetësor, Fakultetin e Mjekësisë/UP, me 20-25 korrik 2025. Shkolla u mbajt falë marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet IKSHPK dhe ETC-PHHP.

Shkolla verore, edicioni i 34-të, me temën bosht: “Komunikimi për Promovimin e Shëndetit” ishte e organizuar për herë të parë në Kosovë. Pjesëmarrës ishin 20 profesionistë shëndetësor dhe studentë, nga të cilët 4 ndërkombëtarë të udhëhequr nga grupi i mësimdhënësve të rrjetit të ETC-PHHP.

Gjatë kësaj jave intenzive, pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen nga afër me mjetet dhe qasjet bashkëkohore që përdoren në komunikimin me komunitetin si dhe patën mundësinë që njohuritë dhe shkathtësitë e fituara t'i demonstrojnë në menyrë praktike.

Temat e trajtuara ishin salutogjeneza dhe dialogu salutogjenik, world kafe, komunikimi salutogjenik në vendin e punës, shkolla, komunitete, universitete, qytete, me sesione teorike dhe praktike në formën e punëtorive dhe diskutimeve aktive. Sesionet e pasdites ishin të organizuara duke shfrytëzuar metodologji moderne në fushën e promovimit dhe edukimit shëndetësor si dhe komunikimit si Structure Interview Matrix, Photo Voice, Participatory Action Research, Capability Cards, Virtual Tools, Artificial Intelligence.

Pjesëmarrësit pos sesioneve teorike dhe praktike, patën mundësinë të diskutojnë për politikat komunale në shërbim të shëndetit të komunitetit, bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe komunitetit për përfshirje sociale dhe barazi dhe u njohën me praktikën e punës me personat me aftësi të kufizuara.

Shkolla Verore Ndërkombëtare për Promovim dhe Edukim Shëndetësor dhe Shëndet Publik ka mbledhur ekspertë, studentë dhe profesionistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të ndarë njohuri dhe përvoja në fushat e shëndetit publik, edukimit shëndetësor dhe promovimit të shëndetit në nivel global. Kjo shkollë ka ofruar mundësi për të shkëmbyer përvojat e suksesshme dhe mësimet e nxjerrura por edhe për të adresuar mënyrat e menaxhimit me sfidat e shëndetit publik, parandalimin e sëmundjeve, promovimin e shëndetit në shkolla dhe komunitete, si dhe mënyrat e shëndetshme të jetesës.



Ass.Dr.sci Rrezarta Bajrami Halili
Departamenti i Mikrobiologjisë
IKSHPK

EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL NË DIAGNOSTIKIMIN E TUBERKULOZIT

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), Departamenti i Mikrobiologjisë kanë organizuar ligjerata në kuadër të planit vjetor dhe programit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional mjekësor të akredituar nga Oda e Mjekëve të Kosovës.

Në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional në bashkëpunim me Oden e Mjekëve të Kosovës është mbajtur ligjerata me datë 12- 13 Maj 2025.

Ligjerata ishte e organizuar me prezencë fizike në Departamentin e Mikrobiologjisë dhe ishte me temën Teknologjia GeneXpert dhe Procedurat për Xpert MTB/RIF për Diagnostikimin e Tuberkulozit dhe Testimin e Rezistencës ndaj Rifampicinës. Ligjerata është mbajtur nga Ass.Dr.sci Rrezarta Bajrami Halili.

Pjesëmarrës me prezencë fizike ishin rreth 35 profesionistë shëndetësor nga Departamentet e Mikrobiologjisë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike si dhe nga QRSHP Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan.



Dr. Aferdita Kuqi-Hyseni
Departamenti i Mikrobiologjisë
IKSHPK

EDUKIMI I VAZHDESHËM PROFESIONAL PËR METODAT IDENTIFIKUESE TË HAEMOPHILUS INFLUENZAE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Departamenti i Mikrobiologjisë kanë organizuar ligjerata në kuadër të planit vjetor dhe programit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional mjekësor të akredituar nga Oda e Mjekëve të Kosovës.

Në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional në bashkëpunim me Oden e Mjekëve të Kosovës është mbajtur ligjerata me datë 15 Maj 2025.

Ligjerata ishte e organizuar me prezencë fizike në Departamentin e Mikrobiologjisë.

Pjesëmarrës me prezencë fizike ishin rreth 50 profesionistë shëndetësor nga Departamentet e Mikrobiologjisë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike si dhe nga QRSHP-të.

Ligjerata me temën Metodat identifikuese të Haemophilus influenzae te moshat Pediatrike u ligjerua nga Dr. Aferdita Kuqi-Hyseni.





Dr. Teuta Fejza
QRSHP Mitrovicë

AKTIVITETET SPORTIVE PËR NDER TË 100 VJETORIT TË IKSHPK ME MOTON “100 VJET PËR SHËNDET ”

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) në bashkëpunim me QRSHP Mitrovicë, QRSHP Ferizaj dhe QRSHP Prizren, ka organizuar aktivitete sportive në kuadër të shënimit të 100 vjetorit të IKSHPK me moton “100 vjet për Shëndet”.

Në Mitrovicë me dt 29.05.2025 nga ora 16h është zhvilluar turnir futbollit me nxënësit e Shkollës së Futbollit U-15 ku në këtë aktivitet kanë qenë 4 ekipe dhe kanë garuar mes vete.

Të gjithë futbollistët kanë qenë të paisur me maica të cilat kanë qenë me logo të 100 vjetorit të IKSHPK.

Turniri është zhvilluar në fushën sintetike të futbollit “ERION VELIJAJ” Mitrovicë në bashkëpunim me KF Trepqa 89.



Është mbajtur fjalim përshendetës për pjesëmarrësit dhe të ftuarit për shënimin e 100 vjetorit nga drejtoresha e QRSHP Mitrovicë, Dr. Teuta Fejza dhe Komisioni i Promovimit dhe Edukimit Shëndetsor, gjithashtu në fund janë ndarë mirënjohje për ekipin fitues, trajnerët dhe gjyqtarët që kanë ndarë drejtësinë në lojën e futbollit.

Në Ferizaj me dt 29.05.2025 nga ora 11h në sallën “Bill Clinton” është zhvilluar turnir futbollit mes punëtorëve shëndetsorë të QKMF-së, QRSHP-së, spitalit rajonal dhe të Qendrës së Shëndetit Mendor.

Ekipa fituese është shpërblyer me kupën e 100 vjetorit të IKSHPK.

Është mbajtur edhe një fjalim nga Drjetoresha Ekzekutive Dr. Ardita Baraku e cila ka përshëndet garuesit dhe pjesëmarrësit e ftuar për shënimin e 100 vjetorit dhe janë dhënë mirënjohje për pjesëmarrësit fitues të Turnirit.

Në Prizren me dt 30.05.2025 është zhvilluar aktivitet sportiv: loja e pingpongut me punëtorët e QRSHP-së dhe veteranët e klubit të pingpongut të Prizrenit. Aktiviteti është zhvilluar në hapsirat objektit të QRSHP Prizren.

Po ashtu edhe në Prizren fjalën përshendetëse e ka mbajtur Dr. Fadil Kryeziu, drejtori i QRSHP-së, e fituesve u janë ndarë mirënjohjet dhe kupa e 100 vjetorit.

Në Prishtinë me dt 30.05.2025 është zhvilluar aktiviteti: turnir basketbolli mes punëtorëve të IKSHPK, MSH dhe QRSHP-ve në sallën “1 TETORI” në Prishtinë dhe janë ndarë mirënjohje dhe medalje për pjesëmarrjen në turnir si dhe kupa e 100 vjetorit të IKSHPK.

Ekipe të cilat kanë garuar mes vete kanë bartur maica me ngjyra të ndryshme dhe mesazhe për shëndetin të përgatitura nga Komisioni për Promovim dhe Edukimi Shëndetsor të QRSHP Mitrovicë dhe IKSHPK si në vijim:

1. Sporti është fuqi dhe jetë
2. Diciplina sjell suksesin
3. Gjumi i mirë sjell shëndet
4. Shëndeti është fitore





Dr. Adnora Nurboja
QRSHP Pejë

KONFERENCA E IV-TË RAJONALE E PROMOVIMIT DHE EDUKIMIT SHËNDETËSOR

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për nder të shënimit të 100 vjetorit të themelimit të IKSHPK ka organizuar Konferencën e IV Rajonale të Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor e cila është mbajtur me datën 04 Qershor 2025 në Hotel International Prishtina, me mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe AQH-së.

Konferenca është akredituar nga Oda e Mjekëve të Kosovës me 12 pikë për pjesëmarrje aktive dhe 10 pikë për pjesëmarrje pasive, si dhe nga Oda e Infermierëve të Kosovës me 20 pikë për pjesëmarrje aktive dhe 15 pikë për pjesëmarrje pasive.

Konferenca ofroi një mundësi për profesionistët, akademikët, studiuesit dhe studentët që të kontribuojnë me punimet e tyre në tema që lidhen me promovimin dhe edukimin e shëndetit sepse kishte në fokus mjediset dhe qasjet e shëndetshme, ndërtimin e partneriteteve drejt shëndetit më të mirë të individit dhe komunitetit.



Tema bosht e Konferencës ishte: “Fuqizimi i komuniteteve të shëndetshme – arritjet dhe sfidat në promovimin e shëndetit”.

Pas fjalës hyrëse të Drejtoreshës Ekzekutive të IKSHPK Dr. Ardita Barakut, konferenca ka filluar punën me sesionin plenar ku janë prezentuar 5 punime nga ligjërues eminent ndërkombëtar dhe ka vazhduar me 6 sesione paralele ku janë prezentuar 40 punime me prezentim oral dhe 24 poster prezentime.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte 263 pjesëmarrës. Temat e konferencës përfshinë:

1. Profilet shëndetësore
2. Ngritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimi ndërsektorial
3. Sëmundjet ngjitëse
4. Sëmundjet kronike jo-ngjitëse
5. Faktorët e rrezikut dhe komunikimi në shëndet publik.



Dr. Shpresa Kushaj
Departamenti i Epidemiologjisë
IKSHPK

TRAJNIMI: “EPIDEMIC INTELLIGENCE NË ECDC”

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve profesionale në shëndetin publik gjatë shkollimit specialistik, një specializante nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike mori pjesë në trajnimin profesional të titulluar “Epidemic Intelligence”, i organizuar nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC), në të cilin kishte nga një përfaqësuese nga secili shtet evropian.

Gjatë këtij trajnimi u ushtruan në mënyrë të strukturuar dhe kronologjike të gjithë hapat kryesorë të inteligjencës epidemike, duke përfshirë skringun e të dhënave, filtrimin, validimin, analizën, dokumentimin dhe komunikimin e informacionit epidemiologjik.

Një sesion i veçantë iu kushtua vlerësimit të shpejtë të rrezikut (Rapid Risk Assessment), ku u prezantua mënyra se si ky proces realizohet në ECDC, duke theksuar rëndësinë e vlerësimit të shpejtë të rrezikut në situata emergjente dhe në përhapjen e mundshme të sëmundjeve infektive.

Po ashtu, gjatë trajnimit u diskutua procesi i inteligjencës epidemike në kontekstin evropian (“Epidemic Intelligence in EU context”), duke u fokusuar në bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare dhe mekanizmat e koordinimit në nivel evropian.

Një prezantim i veçantë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) u mbajt për sistemin EIOS (Epidemic Intelligence from Open Sources) si një mjet i rëndësishëm për mbikqyrjen e bazuar në ngjarje (event-based surveillance), duke shfrytëzuar burime të hapura informacioni për zbulimin e hershëm të rreziqeve shëndetësore.

Gjatë trajnimit pati gjithashtu prezantime nga përfaqësues të shumë shteteve, të cilët ndanë përvojat e tyre mbi mënyrën se si kanë kombinuar sistemet e mbikqyrjes së bazuar në indikatorë me mbikqyrjen e bazuar në ngjarje, duke i integruar ato brenda procesit të përgjithshëm të inteligjencës epidemike.

Pjesëmarrja në këtë trajnim është hap i rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të IKSHPK-së në fushën e inteligjencës epidemike dhe reagimit ndaj emergjencave të shëndetit publik.



PREVALENCA E KONSUMIMIT TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE TE MATURANTËT E RAJONIT TË GJILANIT

Abuzimi i adoleshentëve me substanca narkotike paraqet njërin nga problemet më të mëdha të shëndetësisë publike sot. Në faktorët e riskut të cilat mund të shërbejnë si nxitës për fillim të abuzimit me substanca narkotike përmenden: frustrimi social, papunësia, varfëria, mungesa e perspektivës, raportet jo të mira në familje dhe faktorët ambientalë (ndotja, zhurma, mbipullimit dhe izolimet).

Faktorë të tjerë nxitës përmenden: problemet shëndetësore me dhembje, prapambetja mendore, thyerjet e forta psikologjike, etj. Abuzimi me substanca psiko-stimuluese lë pasoja afatgjate në shëndetin e të rinjve, paaftësi për të krijuar raporte të ndërsjella, shfaqje e sjelljes agresive, auto-agresivitet, ankthi, dezintegrim mendimesh, vetëvlerësim të ulur, sjellje vetëvrasëse, moskujdes për vetveten, si dhe probleme në funksionimin social dhe kognitiv.

Në hulumtim janë përfshirë 424 maturantë me moshë mesatare 18 vjeçare dhe sipas strukturës gjinore prej 41.98% meshkuj dhe 58.02% femra, me vendbanim: 51.65% me vendbanim në qytete dhe 48.35% në fshatra. Në hulumtim janë përfshirë pesë shkolla me 258 maturantë; shkolla e qytetit në Komunën e Vitisë me 94 maturantë dhe dy shkolla në komunën e Kamenicës me 72 maturantë.



Prevalenca e konsumit të substancave narkotike te maturanët e rajonit të Gjilanit ishte 4.5% (19 maturantë), kundrejt 95.5% (405 maturantë) që rezultojnë jo-konsumues dhe nuk evidentonin as përvoja aksidentale të konsumit të substancave narkotike.

Në grupin e drogave të evidentuara mbizotëron konsumimi i kanabisit me nëntë (9) raste (47.4%), metadoni me pesë (5) raste (26.3%), ekstazia me tri (3) raste (15.8%) dhe trodoni me dy (2) raste (10.5%).

Në rastet kur raportet në familje janë të çrregulluara, ka shumë më tepër mundësi për të devijuar nga normat standarde të sjelljes. Nga grupi prej 19 konsumuesve, të 16 prej tyre (84.2%) raportet në familje cilësohen si konfliktuoze dhe në tri raste (15.8%) raportet familjare cilësohen si jo të mira.

Shumica 89.5 % e konsumuesve të evidentuar ndjehen të izoluar nga shoqëria. Izolimi social reflekton në sjelljen e konsumuesit duke e bërë atë më agresiv dhe më pak komunikativ/e. Afër gjysma, 47.4 % e maturanëve konsumues të drogave shkaktojnë delikte ligjore, qoftë si dilerim të substancave, vjedhje, rrëmbime të gjërave me vlerë nga qytetaret e deri të rrahjet masive. Duke qenë se një model i këtyre sjelljes është praktikuar edhe në familje, të gjithë (100%) e maturanëve konsumues të narkotikëve deklarohen se janë izoluar edhe nga familja e tyre.

Hulumtimi po ashtu ka nxjerr një të dhënë interesante: 89.5% e maturanëve të evidentuar si konsumues të substancave narkotike u takojnë familjeve me kushte minimale të jetesës. Nga ky grup 5.3% një (1) jeton në kushte shumë të vështira, 10.5% dy (2) jetojnë në familje me kushte të vështira, dhe 73.7 % (14) prej tyre jetojnë në kushte minimale të jetesës. Vetëm dy (2) prej tyre (10.6%) jetojnë në familjet me kushte të mira dhe shumë të mira të jetesës.



Dr. Donjeta Pllana
Departamenti i Mikrobiologjisë
IKSHPK

REDUKTIMI I KËRCËNIMEVE TERRORISTE DHE FORCIMI I BIOSIGURISË NË BALLKANIN JUGLINDOR: NJË QASJE E INTEGRUAR NË DETEKTIMIN DHE DIAGNOSTIKIMIN E PATOGENËVE EMERGJENT


Departamenti i Mikrobiologjisë, respektivisht Laboratori i diagnostikimit të serologjisë dhe diagnostikës molekulare kanë zhvilluar punëtorinë e diagnostikimit me rol të koordinatorit.

Instituti për Mjekësi Tropikale “Bernard Nocht” ka mbështetur organizimin e takimit të dytë të partnerëve nga Shqipëria, Serbia, Kosova dhe Maqedonia.

Takimi ka përfshirë prezentime shkencore dhe një punëtori diagnostike mbi Ethet Hemoragjike Krime Kongo, virusin Hanta, West Nile dhe Monkey Pox.

Në seancat shkencore janë mbajtur prezentime të secilit shtet lidhur me rastet klinike dhe diagnostikimin e patogjenëve emergjent.

Takimi ka kontribuar në shkëmbimin e përvojave lidhur me detektimin dhe diagnostikimin e patogjenëve emergjent në Ballkanin Juglindor.





Dr. Mirlinda Bytyqi
Departamenti i Epidemiologjisë
IKSHPK

PËRVOJA NGA SHKOLLA VERORE E SHËNDETIT PUBLIK “ANDRIJA ŠTAMPAR”

Me mbështetjen e fondeve të Robert Koch Institut (RKI), në kuadër të shkollimit specialistik, dy specializante nga departamenti i Epidemiologjisë morën pjesë në shkollën verore ndërkombëtare ASSETS 2025, e cila u zhvillua nga data 22–25 korrik 2025 në Shkollën e Shëndetit Publik “Andrija Štampar” në Zagreb, Kroaci.

Programi ASSETS 2025 synon forcimin e liderit në shëndetin publik, promovimin e barazisë shëndetësore, rritjen e qëndrueshmërisë së sistemeve shëndetësore dhe nxitjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare. Programi nisi më 17 korrik me një sesion hyrës online, ku u prezantua struktura dhe objektivat kryesore të shkollës verore.

Hapja zyrtare u bë më 22 korrik, me ligjërata mbi rolin e profesionistëve të shëndetit publik në drejtimin e ndryshimeve, si dhe mbi liderit për qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë. Drejtoresha e shkollës, Mirjana Kujundžić Tiljak, përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu mbështetjen institucionale për programin, ndërsa profesori Stjepan Orešković trajtoi rolin e liderëve të shëndetit publik në përshtatjen me prioritetet globale.

Më 23 dhe 24 korrik, përmes ligjëratave dhe prezantimeve nga pjesëmarrësit dhe profesorët ndërkombëtarë u trajtuan tema që lidhen me rezistencën sistemore, menaxhimin e krizave, barazinë shëndetësore, faktorët komercialë që ndikojnë në shëndet, si dhe sfida konkrete nga vende të ndryshme. Prezantimet e pjesëmarrësve ofruan një pasqyrë të gjerë të praktikave dhe sfidave aktuale në shëndetin publik.



Në prezantimin nga Kosova, u paraqitën të dhënat për zoonozat për vitin 2024, me fokus në brucelozën dhe tularemienë. U raportuan 55 raste të brucelozës dhe 10 raste të tularemisë, kryesisht në komunat bujqësore si Rahoveci, Prizreni dhe Suhareka. U theksua rëndësia e qasjes “One Health”, vaksinimi i kafshëve, forcimi i kapaciteteve laboratorike (PCR) dhe investimi në parandalim, duke marrë parasysh barrën e lartë ekonomike që këto sëmundje paraqesin për sistemin shëndetësor.

Prezantimi tjetër ishte mbi përvojën e Kosovës në hetimin e shpërthimeve të helmimeve ushqimore, me fokus në shpërndarjen sipas grupmoshave, ku më të prekurit ishin fëmijët 3–6 vjeç dhe të rinjtë që konsumojnë ushqim jashtë shtëpisë. U evidentua sezonaliteti i shpërthimeve gjatë muajve qershor–shtator dhe rreziku i shtuar në restorane dhe furra.

Dita e fundit, më 25 korrik, iu kushtua prezantimeve “elevator pitch” dhe diskutimeve përmblyëse, ndërsa programi u mbyll me ndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit.

Pjesëmarrja në ASSETS 2025 u karakterizua nga angazhim aktiv, shkëmbim përvojash ndërkombëtare dhe krijimi i lidhjeve të reja profesionale, duke përfaqësuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin profesional të pjesëmarrësve dhe në forcimin e kapaciteteve të shëndetit publik në vend.

Dr. Albiona Rashiti-Bytyçi & Dr. Shqipe Krasniqi-Kola
IKSHPK, QRSHP Pejë

PËRVOJA NGA SHKOLLA VERORE “BARRA E SËMUNDJEVE INFEKTIVE”

Nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) me mbështetjen e fondeve të Robert Koch Institut (RKI) morën pjesë dy epidemiologë në shkollën verore “Barra e sëmundjeve infektive” në Ghent, Belgjikë, nga data 27 – 29 gusht 2025.

Shkolla verore nën udhëheqjen Institutit Sciensano u organizua në tre module, secili duke kombinuar leksione teorike me seanca praktike:

Moduli 1 – Hyrje në DALY (Disability-Adjusted Life Year) dhe YLL (years of life lost due to premature mortality) ku u prezantua koncepti bazë i barrës së sëmundjes dhe DALY-ve në kontekstin e sëmundjeve infektive.

Aktivitetet: Leksione teorike të ndjekura nga ushtrime praktike të mbikëqyrura nga studiues me përvojë të barrës së sëmundjes.

Moduli 2 – Kërkesat për të Dhëna dhe Modelet e Sëmundjeve me fokus në specifikat e llogaritjes së YLD (years lost to disability) dhe YLL për sëmundjet infektive, duke përfshirë kërkesat për të dhëna.

Aktivitetet: Diskutime teorike të plotësuara nga ushtrime praktike mbi krijimin e modeleve të sëmundjeve për sëmundjet infektive.

Moduli 3 – Shpërndarja dhe Raportimi i Njohurive përmes adresimit të çështjeve praktike që lidhen me përkthimin e njohurive, pasiguritë dhe raportimin në kontekstin e sëmundjeve infektive.

Aktivitetet: Seanca interaktive të përqendruara në komunikimin efektiv të gjetjeve tek palët e interesuara.



Ushtrimet ofruan mundësi për praktikë të mbikëqyrur nga studiues me përvojë të barrës së sëmundjes. Gjatë tre moduleve, pjesëmarrësit u angazhuan në projekt që lidhet me një sëmundje specifike infektive dhe trajtuan mbledhjen e të dhënave, llogaritjen dhe përkthimin e njohurive.

Vlen të theksohet se gjatë moduleve dhe ushtrimeve me të dhënat e shteteve të ndryshme, është vërejtur se Kosova nuk figuron si shtet në bazën e të dhënave të IHME (Institute for Health Metrics and Evaluation), për këtë arsye, nga organizatorët e shkollës verore janë marrë rekomandime për kontaktet e personave përgjegjës që mund të ndihmojnë në inkuadrimin e Kosovës në IHME.

VLERËSIMI I SITUATËS EPIDEMIOLOGJIKE TË REFUGJATËVE NGA AFGANISTANI, 2021-2022

Gjatë periudhës së pandemisë vendi ynë u bë nikoqir i refugjatëve nga Afganistani. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) bëri pritjen dhe testimin e tyre, me qëllim të vlerësimit të gjendjes shëndetësore dhe epidemiologjike.

Gjatë periudhës gusht 2021 - shtator 2022, kanë arritur 30 fluturime me gjithsej 1704 refugjatë prej tyre 933 të rritur (568 meshkuj dhe 365 femra) dhe 771 fëmijë (403 meshkuj dhe 368 femra).

Të gjithë refugjatët u testuan për SARS-CoV-2 duke përdorur testin rapid për antigen, ndërsa ata që ishin të dyshimtë u testuan gjithashtu me testin PCR. Nga testet rapide për SARS-CoV-2, rezultuan pozitiv 9 persona, ndërsa në testin PCR, gjithashtu, 9 persona rezultuan pozitivë.

Refugjatët prezantuan kartela vaksinimi që dëshmonin se ata ishin vaksinuar me vaksinat Johnson & Johnson, Covishield (AstraZeneca), Moderna dhe Pfizer. Numri i personave të vaksinuar ishte 803, prej të cilëve 675 të rritur (460 meshkuj dhe 215 femra) dhe 93 fëmijë (49 meshkuj dhe 44 femra).

Ekipi i IKSHPK-së ka vizituar edhe kampin e refugjatëve, ku u kryen teste për ata që udhëtuan drejt vendeve të Bashkimit Europian, si Belgjika (16 persona), Holanda (24 persona) dhe Lituania (20 persona). Ata u pajisën me raporte që dëshmonin se ishin negativë në testin PCR për COVID-19.





Dr. Besa Sutaj
QRSHP Prishtinë

VLERËSIMI I KUSHTEVE HIGJIENO-SANITARE NË SHKOLLA DHE ÇERDHE TË RAJONIT TË PRISHTINËS, 2025

Qendra Rajonale e Shëndetësisë Publike të Prishtinës, që nga muaji shtator 2025, ka realizuar vizita vlerësuese të kushteve higjieno-sanitare në shkolla dhe çerdhe publike të Rajonit të Prishtinës. Ky aktivitet është realizuar nga Divizioni i Ekologjisë Humane, në bashkëpunim me Divizionin e Mjekësisë Sociale dhe Divizionin e Epidemiologjisë, dhe do të vazhdojë deri në përfundimin e vlerësimit të të gjitha institucioneve arsimore publike në rajon.

Gjatë vizitave në terren janë vlerësuar kushtet higjieno-sanitare të objekteve, është bërë marrja e mostrave të ujit për analiza laboratorike, dhe janë zhvilluar ligjërata edukativo-shëndetësore me nxënësit, me fokus në higjienën personale dhe të ambientit, si dhe në parandalimin e sëmundjeve ngjitëse.

Divizioni i Ekologjisë Humane ka identifikuar rreziqet për shëndetin e fëmijëve dhe ka dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare në ambientet e shkollave dhe çerdheve. Njëkohësisht, stafi i mirëmbajtjes është trajnuar për procedurat e pastrimit, dezinfektimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës, duke siguruar standarde të larta higjieno-sanitare.

Ky aktivitet përfaqëson një shembull konkret të rolit parandalues, edukativ dhe mbikëqyrës të shëndetit publik, duke dëshmuar funksionalizimin praktik të QRSHP Prishtinë në kuadër të IKSHPK-së, në shërbim të shëndetit të brezave të rinj.



Dr. Miranda Lutfiu-Sahiti, Dr. Mirlinda Bytyqi, Dr. Edona Sadiki, Dr. Shpresa Kushaj
Departamenti i Epidemiologjisë
IKSHPK

TRAJNIM PROFESIONAL NË FUSHËN E MBIKËQYRJES EPIDEMIOLOGJIKE

Në kuadër të aktiviteteve profesionale dhe shkencore të organizuara nga IKSHPK, më datë 19 shtator 2025 u organizua trajnimi me temat: “Validimi, analiza dhe standardizimi i të dhënave epidemiologjike” dhe “Përcaktimi i pragjeve epidemike”.

Nën mbikqyrjen e mentorëve klinik, në kuadër të detyrave të programit specialistik trajnimi u mbajt nga katër specializante të Epidemiologjisë, në ambientet e Departamentit të Mikrobiologjisë, me pjesëmarrjen e profesionistëve nga fusha të ndryshme të shëndetit publik. Aktiviteti kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të ekipeve lokale të shëndetit publik në mbikqyrjen epidemiologjike dhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave për vendimmarrje të bazuar në evidencë.

Gjatë trajnimit u diskutuan konceptet themelore të mbikqyrjes epidemiologjike, rëndësia e cilësisë së të dhënave, validimi dhe standardizimi i tyre, si dhe roli që këto procese kanë në paralajmërimin dhe reagimin e hershëm ndaj ngjarjeve shëndetësore. U prezentuan teknika bazike të analizës epidemiologjike, përfshirë ndërtimin e kurbës epidemiologjike dhe llogaritjen e indikatorëve kryesorë, si dhe standardizimi dhe kodimi i të dhënave sipas protokolleve kombëtare dhe ndërkombëtare, me theks në përdorimin e platformave të raportimit epidemiologjik.

Një pjesë e veçantë e trajnimit iu kushtua përcaktimit të pragjeve epidemike, ku u shpjeguan konceptet e pragut bazë, pragut të alarmit dhe pragut epidemik, si dhe metodat e llogaritjes së tyre përmes mjeteve analitike të zakonshme. U diskutuan shembuj praktikë nga konteksti vendor, duke theksuar rolin e pragjeve epidemike në identifikimin e hershëm të shpërthimeve dhe në mbështetjen e vendimmarrjes në shëndetin publik.



Metodologjia e trajnimit përfshiu ligjërata të strukturuar, diskutime interaktive dhe demonstrime praktike. Në përfundim u vlerësua se trajnimi kontribuoi në rritjen e njohurive profesionale, forcimin e kapaciteteve institucionale, avancimin e standardizimit të proceseve të raportimit dhe analizës së të dhënave epidemiologjike në Kosovë.

Dr. Valbona Maloku
QRSHP Prishtinë

PËRVOJA NGA PJESËMARRJA NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE: “NDËRHJRJA NË FËMIJËRINË E HERSHME” LISBONË

Përfaqësues nga IKSHPK dhe QRSHP-të morën pjesë, nga data 2 deri më 5 shtator 2025, në Konferencën Ndërkombëtare “Ndërhjryja në fëmijërinë e hershme”, e mbajtur në ISCTE - Instituti Universitar i Lisbonës.

Konferenca theksoi rëndësinë e ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme (0-6 vjeç) për zhvillimin fizik, mendor dhe emocional të fëmijëve, përmes qasjeve të integruara ndërmjet shëndetësisë, arsimit dhe shërbimeve sociale.

U prezentuan evidenca shkencore, modele funksionale dhe përvoja praktike nga mbi 60 vende të botës, duke reflektuar karakterin global dhe multidisiplinar të kësaj fushe. Roli i institucioneve të Kosovës u theksua në drejtim të implementimit të Programit të Ndërhjryes së Hershme Gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar, me fokus në fuqizimin e kujdesit parësor shëndetësor.



Pjesëmarrja në konferencë kontribuoi në ngritjen e kapaciteteve profesionale, shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare dhe harmonizimin e praktikave vendore me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare. Bazuar në Ligjin për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (LIGJI Nr. 08/L-153), programi parashihet të zbatohet përmes ekipeve multidisiplinare, duke përfshirë profesionistë nga shëndetësia, arsimit dhe shërbimet sociale, me qëllim ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe familjet e tyre. Mbikëqyrja e vazhdueshme e zbatimit të programit të ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme në nivel lokal dhe qendror është e përcaktuar edhe në nenin 30 të Rregullores Nr. 01/2024 të IKSHPK-së.



Dr. Edona Sadiki
Departamenti i Epidemiologjisë
IKShPK

PËRVOJA NË ECDC FELLOWSHIP INTRODUCTORY COURSE 2025

Në kuadër të zhvillimit profesional dhe forcimit të kapaciteteve në pjesën e epidemiologjisë fushore, me ftesë të Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC), bazuar në programin specialistik, një specializante e Departamentit të Epidemiologjisë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), mori pjesë në ECDC Fellowship Introductory Course 2025, i mbajtur në Spetses, Greqi.

Ky trajnim trejavor përfaqëson fazën hyrëse të programit prestigjioz EPIET/EUPHEM, i dedikuar për epidemiologë të rinj, me qëllim përgatitjen e tyre për punë profesionale në hetimin e shpërthimeve, analizën epidemiologjike dhe reagimin ndaj emergjencave të shëndetit publik. Programi ishte i strukturuar në tri javë tematike, duke kombinuar ligjërata teorike, ushtrime praktike dhe punë intensive në grupe multidisiplinare.

Java e parë ishte e fokusuar në bazat e epidemiologjisë fushore dhe survejancës epidemiologjike. U trajtuan konceptet themelore të sistemeve të survejancës, ndërtimi i definicionit të rastit, interpretimi i të dhënave dhe ndërtimi i kurbave epidemike. Pjesëmarrësit u angazhuan në hartimin e pyetësorëve epidemiologjikë, formulimin e hipotezave dhe prezentimin e gjetjeve preliminare bazuar në studime reale të shpërthimeve.

Java e dytë u karakterizua nga avancimi analitik, me theks në dizajnet studimore epidemiologjike (studime kohorte, rast-kontroll dhe studime tërthore), si dhe konceptet e confounding dhe bias-it. Përmes analizës së të dhënave reale dhe ushtrimeve praktike, u ndërtuan argumente epidemiologjike të bazuara në evidencë. Një pjesë e veçantë iu kushtua komunikimit profesional dhe lidershit në epidemiologji, si komponentë kyç për menaxhimin efektiv të situatave të shëndetit publik.

Java e tretë ishte plotësisht praktike dhe e përqendruar në simulimin e një shpërthimi epidemiologjik. Pjesëmarrësit punuan në një skenar të vetëm për disa ditë radhazi, duke përfshirë marrjen e njoftimit fillestar, përcaktimin e definicionit të rastit, mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave. U përdor programi R për analizë statistikore dhe vizualizim epidemiologjik, ndërsa çdo ditë përmbyllej me prezentime të strukturuar të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Pjesëmarrja në këtë trajnim ka kontribuar në avancimin e njohurive praktike në pjesën e epidemiologjisë fushore, veçanërisht në hetimin e shpërthimeve, analizën e të dhënave dhe komunikimin epidemiologjik.

Aftësitë e fituara janë të aplikueshme drejtpërdrejt në punën e përditshme në IKShPK dhe përfaqësojnë një vlerë të shtuar në forcimin e kapaciteteve institucionale për reagim të hershëm dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë.

Ky trajnim përbën një investim të rëndësishëm në zhvillimin profesional të burimeve njerëzore në shëndetin publik dhe kontribuon në harmonizimin e praktikave epidemiologjike të Kosovës me standardet evropiane të ECDC-së.





MSc. Leutrim Murati
Zyra e Drejtorit Ekzekutiv
IKSHPK

PËRVOJA NGA KONFERENCA “ALLWEB”


Në kuadër të zhvillimit profesional dhe forcimit të kapaciteteve në fushën e teknologjisë informative, një zyrtarë i lartë nga IKSHPK mori pjesë në Konferencën AllWeb që u zhvillua në Tiranë me datën 06.11.2025 dhe synim kishte shkëmbimin e informacioneve, përvojave dhe njohurive për zhvillimet në teknologji dhe inovacion.

Kjo konferencë mbledhi profesionistë, ekspertë dhe përfaqësues institucionesh nga vende të ndryshme të rajonit dhe më gjerë, duke ofruar një platformë të rëndësishme për dialog, rrjetëzim dhe bashkëpunim profesional.

Vëmendje e veçantë iu kushtua përdorimit të teknologjisë në punën tonë të përditëshme, përdorimin e Intelgjencës artificiale (AI), automatizimin e proceseve, sigurinë e të dhënave, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve inovative, si dhe përmirësimin e efikasitetit organizativ përmes zgjidhjeve digjitale bashkëkohore.

Pjesëmarrja në këtë konferencë përfaqësoi një mundësi të rëndësishme profesionale për zgjerimin e rrjetit të partnerëve, krijimin e kontakteve të reja profesionale dhe shkëmbimin e përvojave konkrete me aktorë të ndryshëm nga sektori publik dhe privat.

Njohuritë dhe përvojat e fituara nga konferenca AllWeb do të shërbejnë si bazë e rëndësishme për përmirësimin e praktikave profesionale në kuadër të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, veçanërisht në drejtim të avancimit të proceseve digjitale dhe promovimit të inovacionit në shëndetin publik.





TRAJNIM PROFESIONAL PËR PËRDORIMIN E GJUHËS PROGRAMUESE R DHE RSTUDIO

Në kuadër të aktiviteteve profesionale dhe shkencore të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), gjatë muajit shtator-tetor 2025 u realizua cikli i trajnimeve bazike për përdorimin e programit statistikor R dhe mjedisit RStudio, me pjesëmarrjen e profesionistëve nga IKSHPK dhe QRSHP-të.

Trajnimet u zhvilluan nga Dr. Albiona Rashiti Bytyçi, Dr. Besfort Kryeziu dhe Dr. Donjet Bislimi dhe kishin për qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit në analizën statistikore, përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave, si dhe përdorimin e mjeteve bashkëkohore analitike për vendimmarrje të bazuar në evidencë.

Gjatë këtij cikli trajnimesh u trajtuan konceptet bazike të punës me R dhe RStudio, struktura e të dhënave, importimi dhe pastrimi i tyre, analizat statistikore elementare, si dhe interpretimi i rezultateve në kontekstin e shëndetit publik. Trajnimet u realizuan në mënyrë të strukturuar dhe interaktive, duke kombinuar ligjëratat teorike me ushtrime praktike.



Një rëndësi e veçantë iu kushtua aplikimit praktik të analizave statistikore në punën e përditshme të institucioneve të shëndetit publik, me fokus në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së proceseve që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e popullatës.

Pjesëmarrësit shprehën interes dhe angazhim të lartë gjatë gjithë ciklit të trajnimeve, duke kontribuar në diskutime profesionale dhe shkëmbim përvojash ndërmjet rajoneve të ndryshme.

Ky cikël trajnimesh përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi shëndetësor më të fuqishëm dhe të orientuar nga të dhënat, duke reflektuar përkushtimin e vazhdueshëm të IKSHPK-së për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe avancimin e shëndetit publik në Kosovë.



Dr. Pranvera Kaçaniku- Gunga
Departamenti i Epidemiologjisë
IKSHPK


IKSHPK PRANOHET NË RRJETIN GLOBAL PËR ALARM DHE REAGIM NDAJ SHPËRTHIMEVE (GOARN)

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve kombëtare dhe avancimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shëndetit publik, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), departamenti i Epidemiologjisë, në mars të vitit 2025, ka aplikuar për anëtarësim në Rrjetin Global për Alarm dhe Reagim ndaj Shpërthimeve (Global Outbreak Alert and Response Network – GOARN), një mekanizëm kyç i Organizatës Botërore të Shëndetësisë për koordinimin e reagimit ndaj emergjencave shëndetësore globale.

Aplikimi i IKSHPK-së u mbështet në rolin qendror të Departamentit të Epidemiologjisë në mbikëqyrjen epidemiologjike, parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, si dhe në përvojën e dëshmuar gjatë menaxhimit të pandemisë COVID-19, reagimit ndaj epidemive të shpeshta të sëmundjeve që përhapen me ujë dhe ushqim, sëmundjeve zoonotike dhe riemergjente.

Një komponent tjetër i rëndësishëm i kapaciteteve institucionale përfaqësohet nga laboratorët e IKSHPK-së, të cilët ofrojnë diagnostikë mikrobiologjike dhe virologjike, monitorim të sigurisë së ujit dhe ushqimit, si dhe mbështetje laboratorike gjatë shpërthimeve.

Pas vlerësimit të kapaciteteve institucionale dhe përmbushjes së kriterëve përkatëse, më 28 tetor, IKSHPK është pranuar zyrtarisht si anëtar i GOARN, duke u bërë pjesë e një rrjeti global institucionesh dhe ekspertësh që kontribuojnë në parandalimin, zbulimin e hershëm dhe reagimin ndaj shpërthimeve epidemike dhe kërcënimeve të tjera serioze për shëndetin publik.



Në kontekstin e anëtarësimit në GOARN, IKSHPK është në gjendje të kontribuojë me ekspertizë profesionale në hetime në terren, menaxhim të shpërthimeve, vlerësime të rrishtit, diagnostikë laboratorike, parandalim dhe kontroll të infeksioneve, trajnime për profesionistët shëndetësorë, si dhe në mbështetjen e fushatave të vaksinimit dhe komunikimit të rrishtit gjatë emergjencave shëndetësore.

Pranimi i IKSHPK-së në GOARN përfaqëson një arritje të rëndësishme institucionale dhe një hap strategjik në integrimin e Kosovës në mekanizmat global të sigurisë shëndetësore. Ky anëtarësim forcon gatishmërinë kombëtare për menaxhimin e emergjencave shëndetësore, rrit shkëmbimin e njohurive dhe përvojave profesionale, si dhe mundëson kontributin aktiv të institucioneve të shëndetit publik të Kosovës në mbrojtjen e shëndetit global.

Prof. Asoc. Dr Valbona Zhjeqi
Departamenti i Mjekësisë Sociale
IKSHPK

MATJA E KËNAQSHMËRISË SË PACIENTIT NË TRE NIVELET E KUJDESIT SHËNDETËSOR NË KOSOVË

Projekti “Matja e kënaqshmërisë së pacientit në tre nivelet e kujdesit shëndetësor në Kosovë” zbatohet nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), me përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë, me synim ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm për matjen e përvojës së pacientit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në sistemin shëndetësorë.

Projekti synon të vlerësojë në vazhdimësi kënaqshmërinë e pacientëve në kujdesin parësor, dytësor dhe tretësor; të identifikojë fushat problematike dhe nevojat për përmirësim; të mbështesë vendimmarrjen me të dhëna objektive; si dhe të forcojë marrëdhënien staf–pacient, duke e vendosur pacientin në qendër.

Fushata sensibilizuese u përkrah nga projekti zviceran Accessible Quality Healthcare (AQH) për dizajnimin e videos dhe për printimin e posterëve e fletëpalosjeve, me qëllim informimin e qytetarëve për qasje në pyetësor përmes telefonit duke skanuar QR kodin. Në të gjitha institucionet shëndetësore në tre nivelet janë vendosur posterë, fletëpalosje dhe QR kode të qasshme për pacientët.



Mbledhja e të dhënave bazohet kryesisht në QR kode të vendosura në pika të dukshme, me shtrirje në 38 QKMF, 7 spitale rajonale dhe 31 klinika të QKUK. Matja po realizohet përmes një platforme elektronike me qasje në kohë reale, e cila u mundëson institucioneve shëndetësore dhe nivelit qendror në IKShPK të shohin rezultatet dhe të gjenerojnë raporte periodike.

Më 3 dhe 4 nëntor 2025 u realizua trajnimi për përdorimin, interpretimin e të dhënave dhe përpilimin e raporteve periodike, me pjesëmarrje të dy përfaqësuesve nga secili institucion: 76 pjesëmarrës nga QKMF dhe 79 përdorues për komponentën spitalore (KDSH/QKUK/IKSHPK).

Mesazh kyç i projektit është se pacienti nuk është vetëm marrës i shërbimit, por partner në përmirësimin e sistemit shëndetësor. Dëgjimi i përvojës së pacientit forcon besimin dhe e kthen matjen e kënaqshmërisë nga “Pyetësor formal” në mekanizëm real për përmirësim.

USHTRIMI SIMULUES “OPERATION VECTOR”

Me datë 11-12 Nëntor 2025 në Statens Serum Institut në Kopenhagë, Danimarkë, Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollën e Sëmundjeve (ECDC) përfundoi ushtrimin simulues “Operation Vector” të organizuar në bashkëpunim me Europol.

Në këtë ushtrim morën pjesë 62 përfaqësues nga shtetet anëtare të BE/EEA-së, 18 përfaqësues nga vendet e zgjerimit të BE-së dhe Partneritetit Lindor dhe disa lehtësues dhe vëzhgues për të forcuar kapacitetet e përgatitjes dhe përgjigjes ndaj incidenteve të qëllimshme biologjike. Shteti i Kosovës u prezantua nga përfaqësues të IKSHPK-së, Departamenti i Epidemiologjisë.

Në total, mbi 100 profesionistë operativ dhe teknikë nga sektori i shëndetit publik dhe të zbatimit të ligjit morën pjesë së bashku me përfaqësues relevant të Drejtorisë së Përgjithshme për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore (DG SANTE) dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Migracionin dhe Çështjet e Brendshme (DG HOME) të Komisionit Evropian, si dhe të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) duke përdorur ekspertizën e tyre në fusha të ndryshme për tu përballur me kriza fiktive por të mundshme.



Pjesëmarrësit punuan përmes një skenari kompleks që përfshinte lirimin e qëllimshëm të një patogjeni të modifikuar gjenetikisht, duke përdorur sistemin e paralajmërimit të hershëm (EWARS) të zbatuar në nivel të BE-së ose Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit (IHR) dhe testuan shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin ndër sektorial.

Ushtrimi simulues u përqendrua në pesë objektiva kryesore:

1. Shqyrtimi i planeve të gatishmërisë dhe mekanizmave të paralajmërimit të hershëm
2. Vëzhgimi i kapaciteteve operative të përgjigjes nëpër sektorë
3. Forcimi i koordinimit ndërkufitar dhe ndër sektorial
4. Përforcimi ndër sektorial i komunikimit të riskut me publikun gjatë një kërcënimi biologjik me zhvillim të shpejtë
5. Identifikimi i mangësive në masat e bio-sigurimit dhe protokollet e emergjencës në një skenar të çlirimit të qëllimshëm.

Sesionet përfshinin hapa të vendimmarrjes operative, analiza bashkëpunuese dhe sesione informimi që kishin për qëllim identifikimin e pikave të forta dhe fushave për përmirësim.


Ky ushtrim simulues ishte një mundësi e mirë për të siguruar një bashkëpunim më efektiv në mes sektorëve dhe vendeve.

ANALIZA GJEOGRAFIKE DHE HAPËSINORE E SËMUNDJEVE NGJITËSE NË RAJONIN E PRISHTINËS

Në kuadër të avancimit të mbikëqyrjes epidemiologjike dhe modernizimit të analizës së të dhënave të sëmundjeve ngjitëse, Qendra Rajonale e Shëndetësisë Publike në Prishtinë ka filluar aplikimin e Sistemit të Informacionit Gjeografik Kuantik (Quantum Geographic Information System- QGIS) për të kryer analizën gjeografike e hapësinore. Kjo analizë ofron një kuptim më të thellë të shpërndarjes së sëmundjeve ngjitëse përmes paraqitjes grafike dhe të detajuar përmes hartave.

Analiza gjeografiko-hapësinore konsiston në lidhjen e rasteve të raportuara të sëmundjeve ngjitëse me njësitë administrative përkatëse (komunat, zona urbane dhe/ose rurale), që pasqyrohet përmes hartave digjitale. Duke përdorur QGIS, të dhënat numerike nga mbikëqyrja epidemiologjike integrohen me shtresat gjeografike, duke krijuar grafikone të hartave që pasqyrojnë intensitetin, shpërndarjen dhe ndryshimet hapësinore të sëmundjeve në kohë reale ose për periudha të caktuara.

Fillimi i kësaj analize paraqet një zhvillim të rëndësishëm drejt digjitalizimit dhe avansimit të mbikëqyrjes së SMSN, sepse përmirëson cilësinë e analizës epidemiologjike dhe raportimit profesional, por gjithashtu kontribuon në reagim dhe raportim më të shpejtë ndaj sëmundjeve ngjitëse.





Prof. Ass. Dr Xhevat Jakupi
Departamenti i Mikrobiologjisë
IKSHPK

VIZITA BINJAKËZUESE NË DEPARTAMENTIN E MIKROBIOLOGJISË TË LABORATORËVE REFERENTË SHËNDETËSORE TË LUKSEMBURGUT

Në kuadër të programit AURORAE të Qendrës Evropiane për kontrollë të sëmundjeve, Prof. Ass. Dr. Xhevat Jakupi, Specialist i Mikrobiologjisë në Departamentin e Mikrobiologjisë të IKSHPK-së vizitohet Njësia për sekuecimin e patogjenëve në Departamentin e Mikrobiologjisë të Laboratorëve Referente Shëndetësore (Laboratoire National De Santé - LNS) në Dudelange të Luksemburgut.

Qëllimi i vizitës ishte njoftimi me procesin e sekuecimit të SARS-CoV-2 bazuar në protokolet e punës në LNS duke filluar nga procesi i pranimit dhe regjistrimit të mostrave në sistemin informativ laboratorik e deri në analizën e të dhënave të fituara nga sekuecimi përmes programeve të ndryshme të bioinformatikës. Përveç kësaj, me mikpritësit u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit në kuadër të veprimtarisë së përbashkët të Departamenteve të Mikrobiologjisë.

Mbikëqyrja e gjenomit të patogjenëve me potencial epidemik dhe pandemik ndihmon në të kuptuarit më të mirë të evoluimit të tyre duke ndikuar në këtë mënyrë në vlerësim të hershëm të rreziqeve dhe përgjigjeve adekuate.

Mbikëqyrja gjenomike e patogjenëve me prioritet për shëndetin publik të Kosovës është njëra ndër fokuset kryesore të punës së Departamentit të Mikrobiologjisë në IKSHPK, e theksuar edhe në Planin strategjik kombëtar të Kosovës për laboratorë 2024-2030 si dhe në draft Planin e veprimit për mbikëqyrje gjenomike për patogjenët me potencial pandemik dhe epidemik 2026-2028.



Dr. Aferdita Kuqi-Hyseni, Dr. Afërdita Kurti-Meta
Departamenti i Mikrobiologjisë
IKSHPK

TRAJNIM TEORIK DHE PRAKTIK PËR IZOLIMIN, IDENTIFIKIMIN DHE REZISTENCËN ANTIMIKROBIKE TË BAKTEREVE ANAEROBE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), Departamenti i Mikrobiologjisë kanë organizuar ligjerata dhe pjesë praktike në kuadër të Planit të Veprimit për Rezistencën Antimikrobike të Kosovës, duke kontribuar drejtpërdrejt në zbatimin e masave për forcimin e mbikqyrjes laboratorike dhe përmirësimin e cilësisë së diagnostikimit mikrobiologjik në vend.

Trajnimi u mbështet nga Robert Koch Institute, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në ndërtimin e kapaciteteve dhe avancimin e cilësisë së shërbimeve laboratorike.

Pjesëmarrës me prezencë fizike ishin rreth 33 Mikrobiolog dhe Laborantë nga Departamentet e Mikrobiologjisë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike si dhe nga QRSHP Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaj, Mitrovica dhe Gjlani.



Pjesa kryesore e programit iu kushtua praktikës laboratorike intensive, e zhvilluar në Laboratorin Referent për Rezistencë Antimikrobike. Pjesa praktike ofroi udhëzime të drejtpërdrejta dhe mbështetje profesionale gjatë gjithë procesit të punës laboratorike.

Ky trajnim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të diagnostikimit laboratorik, standardizimit të praktikave mikrobiologjike dhe forcimit të kapaciteteve kombëtare në fushën e rezistencës antimikrobike, duke kontribuar në përmirësimin e programeve të Kujdestarrisë Antimikrobiale dhe sigurisë së pacientit.

Përmes këtij aktiviteti, IKSHPK riafirmon angazhimin për zhvillim profesional të vazhdueshëm dhe për adresimin efektiv të sfidës globale të rezistencës antimikrobike.





Dr. Teuta Musliu
Departamenti i Epidemiologjisë
IKShPK

HELMIMET ME USHQIM GJATË VITIT 2024 NË KOSOVË

Në IKShPK, gjatë vitit 2024, janë raportuar 10 epidemi të helmimeve me ushqim, prej tyre 7 janë epidemi kolektive dhe 3 epidemi familjare. Të gjitha këto raste të raportuara me intoksikime, kanë konsumuar apo blerë ushqim në fast-food, furrë buke apo restorane. Si shkaktarët patogjen të izoluar në mostra të ushqimit dhe koprokulturë, në 30% të mostrave është izoluar Salmonella enteritidis, në 10% të mostrave është izoluar Staphylococcus aureus, ndërsa në 60% të rasteve nuk është marrë mostra ose është marrë pas përdorimit të antibiotikëve.

Shkaktarët e izoluar në mjetet e punës, strishot e ambientit dhe duart e personelit, janë Staphylococcus aureus në 40% të mostrave, me nga 30% të mostrave janë izoluar Escherichia coli dhe Staphylococcus saprophyticus, kurse në 10% të mostrave janë izoluar Staphylococcus albus, Staphylococcus epidermidis, Acinetobacter spp., Enterococcus spp., Enterobacter aerogenes. Klebsiella pneumoniae dhe Klebsiella spp.

Të ekspozuar kanë qenë 706 persona, prej tyre, të sëmurë 131 raste (shkalla e sulmit 18.5%) dhe të hospitalizuar 41 raste (31.2%). Grup moshë më e atakuar ishte 20- 29 vjeç me 36.4%. Më e prekur gjinia mashkullore me 58% sesa gjinia femërore me 42% të rasteve.

Sa i përket sezonalitetit të paraqitjes së epidemive, numër më i lartë i tyre janë paraqitur gjatë muajit gusht (4 epidemi) ku për shkak të temperaturave të larta, shumimi i mikroorganizmave është më i shpejtë dhe vie deri te prishja më e lehtë e ushqimeve.

Bazuar në Analizën e rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP), në 83% të rasteve, nuk është zbatuar kontrolli i rreziqeve të sigurisë ushqimore dhe zbatimi i praktikave higjienike në të gjithë linjën e prodhimit të ushqimit.

Hetimet vunë në dukje gabime të mundshme në praktikat higjienike në kontekstin e shfaqjes së higjienës joadekuate të duarve të personelit që shërbenin ushqim, menaxhimit të dobët të lavanderisë dhe higjienës joadekuate të ambientit të punës.

Gjetjet laboratorike e epidemiologjike treguan se burimi i shpërthimit në 75% të epidemive ishte sosi i majonezës me ç'rast, Salmonella Enteritidis shpesh e lidhur me vezë të kontaminuara, mund të jetë futur në majonezë. Zbulimi i Staphylococcus aureus u identifikua në shtupa të marra nga duart e mbajtësit të ushqimit gjë që thekson rëndësinë e ruajtjes së higjienës personale në zonat e përgatitjes së ushqimit.





Prof. Asoc. Dr. Sanije Gashi
Departamenti i Statistikave Shëndetësore
IKSHPK

VJETARËT STATISTIKOR TË DEPARTAMENTIT TË STATISTIKAVE SHËNDETËSORE NË IKSHPK

Departamenti i Statistikave Shëndetësore në IKSHPK së bashku me njësitë e SISH në Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik mbledhë, agregon, analizon dhe interpreton të dhënat shëndetësore për të mbështetur politikëbërjen dhe vendimmarrjen e bazuar në evidencë, planifikimin strategjik dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Përpos analizave specifike dhe sipas kërkesës çdo vit publikon 13 vjetar statistikor të cilët vendosen edhe në webfaqen e IKSHPK.

Lista e vjetarëve të statistikave shëndetësore:

1. Resurset humane në Shëndetësinë e Kosovës (sektori publike) gjendja 31.12.
2. Vizitat në Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH) në Kosovë për periudhën Janar-Dhjetor (Sektori Publik)
3. Burimet njerëzore, aktivitetet dhe indikatorët në spitalet rajonale
4. Burimet njerëzore, aktivitetet dhe indikatorët në QKUK
5. Lindjet në Institucionet Shëndetësore Publike të Kosovës
6. Raporti i sëmundjeve malinje për periudhën Janar-Dhjetor
7. Raporti i sëmundjeve masovike jongjitëse për periudhën Janar-Dhjetor
8. Raporti i morbiditetit në Kujdesin Parësor Shëndetësor për periudhën Janar-Dhjetor.
9. Raporti i morbiditetit në Kujdesin Dytësor Shëndetësor për periudhën Janar-Dhjetor.
10. Raporti i morbiditetit në Kujdesin Tretësor Shëndetësor për periudhën Janar-Dhjetor.
11. Insuliovartësit në Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH) për periudhën Janar-Dhjetor.
12. Raporti për burimet njerëzore dhe aktivitetet e laboratorit mikrobiologjik në IKSHPK dhe QRSHP në Kosovë për periudhën Janar-Dhjetor.
13. Raporti për burimet njerëzore dhe aktivitetet e laboratorit të ekologjisë humane në IKSHPK dhe QRSHP në Kosovë për periudhën Janar-Dhjetor.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta për rritjen e cilësisë së statistikave shëndetësore të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private çdo vit organizohen punëtori profesionale.



PËRVOJA NGA PUNËTORIA PËR RAPORTIMIN E SËMUNDJEVE KRONIKE JONGJITËSE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës me 14 Gusht 2025 ishte nikoqir i punëtorisë mbi Raportimin e Sëmundjeve Kronike Jo Ngjitëse, e udhëhequr nga Prof. Ass. Dr. Sanije Hoxha-Gashi.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të Shkollës Verore SSPH+ Lugano (SSPH+ LSS), pjesë e qendrës “HUB Kosova”, në bashkëpunim me projektin Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (AQH) dhe Shërbimet e Integruara Shëndetësore (IHS).

Punëtorja u zhvillua në kohën kur Ministria e Shëndetësisë, përmes një qarkoreje informative, rikujtoi se raportimi i sëmundjeve kronike jo ngjitëse është një proces i detyrueshëm për të gjitha institucionet shëndetësore.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të thellojnë njohuritë praktike për raportim të saktë dhe të standardizuar, duke kontribuar kështu në përmirësimin e mbikëqyrjes shëndetësore dhe planifikimin e politikave publike.





Dr. Sanije Xhemajli
QRSHP Prishtinë

THEMELIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I QRSHP PRISHTINË

Me datën 11 gusht 2025, u themelua Qendra Rajonale e Shëndetësisë Publike në Prishtinë (QRSHP). Me 26 shtator 2025 u bë edhe përirimi i kësaj qendre me shërbimet e Epidemiologjisë, Ekologjisë Humane dhe Mjekësisë Sociale për komunat e Rajonit të Prishtinës.

Fillimi i funksionimit të Qendrës Rajonale të Shëndetësisë Publike në Prishtinë shënon një hap të rëndësishëm në zhvillimin dhe modernizimin e sistemit të shëndetësisë publike në vend, duke fuqizuar përpjekjet për parandalimin e sëmundjeve, promovimin dhe edukimin shëndetësor, monitorimin e cilësisë së ujit, ajrit dhe ushqimit, të gjitha këto në kuadër të mbrojtjes së shëndetit të popullatës.

Si pjesë e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, QRSHP Prishtinë ka për mision monitorimin e gjendjes shëndetësore të popullatës, mbikëqyrjen epidemiologjike dhe reagimin e shpejtë ndaj rreziqeve që kanosin shëndetin publik. Funkcionalizimi i saj po konsolidohet si një pikë referimi për shëndetin publik në rajon, duke garantuar reagim profesional si dhe një koordinim institucional adekuat.

